

RAPORTIMI JAVOR

PËRGATITUR NGA: Zj. STOLI LAZE, Auditues Ligjor
DREJTUAR: KOMISIONIT QENDROR ZGJEDHOR
DATA: 01/07/2019
OBJEKTI: Raporti Javor i ndërmjetëm i monitorimit

Monitorues/Eksperti financiar: Zj. STOLI LAZE

Zgjedhjet: ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019

Partia/subjekti elektoral: PARTIA E REFORMAVE DEMOKRATIKE SHQIPTARE

Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara:

- QARKU TIRANË
 - BASHKIA TIRANË
- QARKU KUKËS
 - BASHKIA KUKËS
 - BASHKIA HAS
 - BASHKIA TROPOJË
- QARKU DIBËR
 - BASHKIA MAT
 - BASHKIA BULQIZË
- QARKU SHKODËR
 - BASHKIA MALËSI E MADHE
- QARKU ELBASAN
 - BASHKIA ELBASAN
 - BASHKIA LIBRAZH D
 - BASHKIA GRAMSH
- QARKU GJIROKASTËR
 - BASHKIA KËLCYRË



Shkeljet e mundëshme të identifikuara të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore:

Zyrat elektorale

Nga monitorimi i kryer prej datës **24 Qershor 2019** deri më **30 Qershor 2019** rezultoi sa më poshtë:

Zyrat Elektorale / Zyra e lagjeve / zgjedhjeve,

- Kemi marrë përgjigje me shkresë zyrtare me postë, nga Bashkia Tiranë, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Tropojë, Bashkia Gramsh, Bashkia Has, Bashkia Mat për informacione për zyrat elektorale të partisë së sipër përmendur, në kuadër të detyrimit ligjor të subjekteve zgjedhore të deklarimit të vendodhjes së zyrave elektorale në këto bashki. Te gjitha këto bashki na informojnë se Partia e Reformave Demokratike Shqiptare nuk ka dhënë informacion mbi adresat e sakta të zyrave elektorale në territorin e këtyre bashkive.
- Nuk kemi identifikuar asnjë zyrë elektorale nga monitorimi në terren.
- Nga kontakti i vendosur me kryetarin e subjektit zgjedhor Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, z. Krenar Rryçl, na është komunikuar prej tij që nuk ka zyra elektorale.

Natyra e shkeljeve:

- Nuk është zbatuar detyrimi që i lind subjektit Partia e Reformave Demokratike Shqiptare ashtu siç percaktohet në pikën 3 të Udhëzimit nr1 date 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore" i ndryshuar që të njoftoj me shkresë Bashkitë ku ka kandidat për këshillat bashkiake që nuk ka zyra elektorale.

Materiale të fushatës të ndaluara

- Gjatë monitorimit të kryer nuk kemi vërejtur, materiale të ndaluara gjatë fushatës.

Eksperti Financiar

Auditues Ligjor

Stoli IAZ



Miraturar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

**EKSPERTE E MONITORIMIT TË SHPENZIMEVE TË FUSHATËS ZGJEDHORE
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 TË
PARTISË REFORMAVE DEMOKRATIKE SHQIPTARE**

STOLI LAZE

Tiranë më 01/07/2019

Drejtuar : *Komisionit Qendror Zgjedhor KQZ*

Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë

Për djeft : *Partia e Reformave Demokratike Shqiptare*

Rr."Muhamet Gjollësia" ish Shtëpia Botuese 8 Nentori, Tirane

Lenda: Shkresë përcjellëse "Raporti i monitorimit të shpenzimeve për fushatën zgjedhore për Organet e Qeverisjes Vendore nga Subjekti Zgjedhor "*Partia e Reformave Demokratike Shqiptare*"

Bazuar në kontratat e shërbimit nr 5068. prot. Datë 01.06.2019 me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Neni 6 dhe Udhëzimin e KQZ Nr.2 datë 01.06.2017 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës zgjedhore, nenin 3, sipas të cilit:

Unë eksperte financiar e emëruar sipas këtij udhëzimi monitoruam në mënyrë specifike:

- a) zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017;
- b) Identifikimi i zyrave elektorale në terren
- c) Komunikimi me shkresa zyrtare Bashkive ku janë kandidatë;
- d) rregullat e brendshme të subjektit elektorale për raportimin e shpenzimeve;

Po ju përcjellim bashkëlidhur Raportin Javor te dates 24 Qershor 2019 - 30 Qershor 2019
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**Eksperte Financiar
Stoli Laze**

